



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Mbështetje financiare për fermerët e bashkuar

2017-12-20 10:39:00



Mbështetje financiare për fermerët e bashkuar

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Niko Peleshi gjatë vizitës së tij në Qarkun e Beratit, ka zhvilluar dhe një takim me fermerët e fshatit Drenovicë, Bashkia Ura Vajgurore.

Gjatë bashkëbisedimit me banorët, Ministri u ka shpjeguar të pranishmëve nevojën e riorganizimit dhe bashkimit në formacione më të mëdha, siç janë SHBB (Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor), të cilat janë më të avantazuara, përse i përket skemës së mbështetjes.

“Do mbështesin rritjen e sipërfaqes së serave, do t’ju mbështesim me subvencion prodhimin, por ju inkurajojmë edhe që të rriteni. Në qoftë se nuk keni mundësi të merrni toka me qira dhe të bëni sera, atëherë bashkohuni. Nuk po themi që të bashkoheni në kooperativë, si qëmoti, pra të bashkoni tokën, vazhdoni secili tokën e vet, por bashkohuni në një SHBB, apo në një grup fermerësh, apo bëhuni bashkë, sepse po të jeni bashkë keni mundësi të përfitoni më tepër.”

“E vetmja, që ne kërkojmë nga ju, është që edhe ju të bëni një hap përpara. Ne do bëjmë një hap përpara dhe ju duhet të bëni një hap përpara. E kam fjalën për organizimin tuaj, që është në dobinë tuaj, por për shkak të mentalitetit tonë, ne e kemi një çik të vështirë të bashkëpunojmë. Duhet të filloni bashkëpunimin në shitje apo në blerjen e inputeve, që të rrisni fermat.”

“Kështu, që sa më shumë të bashkoheni ju, aq më të thjeshtë e kanë grumbulluesit të bëjnë kontrata të mëdha. Sepse, me 500 fermerë është më e vështirë, sesa të merresh me 30.”

Ministri ka qenë i qartë dhe gjatë shpjegimeve, në lidhje me riorganizimet e Drejtorive të Bujqësisë, dhe produkteve të cilave, do t’u jepet përparësi në skemën e mbështetjes financiare, si dhe mënyrës së veprimit për të tregtuar mallin. Duke filluar që nga prodhimi, grumbullimi, ambalazhimi, çertifikimi dhe negociimi me njësitë tregtare.

“Ndaj kur themi që do t’i shpërbëjmë drejtoritë e bujqësisë, nuk do të thotë që do t’i shkrijmë, por do t’i riorganizojmë.”

“...Ato produkte, që janë produkte eksporti, apo që mund zëvendësojnë importin, që janë të konkurrueshme, që kanë treguar se janë të suksesshme, ... ne duhet t’i mbështesim në çdo ferme. Çdo fermer duhet ta ketë një pikë kontakti me agronomin, për t’u këshilluar gjatë sezonit të mbjelljes. Këtë gjë do ta arrijmë!”

“Ndërsa, po të jeni bashkë, zgjidhni një negociues, edhe çmimi që merrni është më i mirë.”

Gjatë këtij takimi, Ministri Peleshi u shoqërua nga deputetë të Qarkut Berat, përfaqësues të pushtetit vendor dhe zëvendësministri Dhimo Kote.